

REPUBLIKA E KOSOVËS
REPUBLIKA KOSOVA – REPUBLIC OF KOSOVA
GJYKATA THEMELORE NË PRISHTINË
OSNOVNI SUD PRISHTINA – BASIC COURT OF PRISTINA

PKR.nr.33/18

NË EMËR TË POPULLIT

GJYKATA THEMELORE NË PRISHTINË, DEPARTAMENTI I KRIMEVE TË RËNDA – në trupin gjykues të përberë nga gjyqtarja Shadije Gërguri- kryetare e trupit dhe anëtarëve të trupit gjykues-gjyqtarët Beqir Kalludra dhe Lutfi Shala, me zyrtarin ligjorë Arianit Mahmutaj në lëndën penale ndaj të akuzuarit A.R.për shkak të veprës penale Sulmi në bashkëkryerje nga neni 187 par.2 lidhur me nenin 31 të KPK-së, sipas aktakuzës së ish Prokurorisë Themelore në Prishtinë PP/I.nr.306/2015, të dt: 18.08.2015 pas mbajtjes së shqyrtimit gjyqësorë verbal e publik me dt: **09.07.2018**, në prezencë të prokurorit të qështjes Armend Hamiti, të akuzuarit A.R.dhe mbrjotëses së tij av.L.B-Y., të njëjtën ditë, publikisht shpallë:

A K T G J Y K I M

I akuzuari:

A.R., nga i ati A. e ëma Zh., e gjinisë G., i lindur me dt: ..., në P., me vendbanim në F.K., lagjja “B.” blloku ..., hyrja ...kati i ...nr...., ka tëkryer shkollën e mesme, jo i punësuar, i pamartuar, i gjendjes së mesme ekonomike, Shqiptar Shtetas i Republikës së Kosovës, i cili gjindet në arrest shtëpiak nga data: 29.04.2015. me nr. personal:

ËSHTË FAJTOR

SEPSE: Me datë kohe dhe vend të përshkruar si në dispozitivin nr.1 të Aktakuzës kanë shkuar në lokal “M.B.” në F.K. pronar i të cilit është i akuzuari I.K. në atë mënyrë që për shkak të një mosmarrëveshje që kishte ndodhur një ditë më heret në mes të akuzuarve I.K.dhe L.R., ku me datën e lartcekur L.R.se bashku me vëllain e tij A.R.dhe me shokët D.V. dhe A.H. dhe të miturit A.M dhe B.O kanë shkuar në kafiterin e lartcekur, me qelim që ta sulmojnë I.K., ku L.R.dhe A.R.kishin ka një thike në dorë, kurse D.V. A.H.dhe se bashku me të miturit A.M dhe B.O kishin shkopinj dhe shufra, kanë hyrë në lokal me qëllim që të sulmojnë I.K., si është përshkruar në dispozitivin e parë,-

-me çka ka kryer veprën penale: Sulmi në bashkëkryerje nga neni 187 par.2 lidhur me nenin 31 të KPRK-së,

Andaj gjykata në kuptim të neneve 2,4,7,17,31,41, 42,49,50,51,52,53,73,75,76,të KPRK-së dhe neneve 365 dhe 450 të KPPK-së

Të akuzuarin **A.R.**,

Për veprën penale Sulmi në bashkëkryerje nga neni 187 par.2 lidhur me nenin 31 të KPK-së,i shqiptohet **DENIM ME KUSHT- DENIM BURGU** ne periudhe kohorë prej **6 (gjashtë) mujash** i cili dënim nuk do te ekzekutohet nëse i njehti brenda afatit kohorë prej **1 (një) viti**, nuk kryen vepër tjetër penale. Në rast të revokimit të denimit me kusht, koha e kaluar në arrest shtëpiak nga data: 29.04.2015 deri me dt:25.09.2015 i llogaritet në denimin e shqiptuar.

MBI SHPENZIMET E PROCEDURËS PENALE DHE PAUSHALLIN GJYQËSOR

I akuzuari A.R., obligohet të paguajë shpenzimet e procedurës penale sipas llogarisë të kësaj gjykate, ndërsa në emër të paushallit gjyqësor të paguajnë shumën prej 50 € (psëdhjet) Euro, në afat prej 15 ditësh nga dita e plotfuqishmërisë të këtij aktgjykimi.

A r s y e t i m

Prokuroria Themelore në Prishtinë, Departamenti për krime të rënda, ka ngritur aktakuzë PP/Inr.306/2015, të dt: 18.08.2015, kundër të akuzuarëve I.K., R.K. V.I. për shkak të veprës penale Vrasje e rëndë në tentativë nga neni 179 par.1 nën.par.1.5 lidhur me nenin 28 dhe nenin 31 të KPK-së, L.R., D.V., E.M., A.H., A.R.për shkak të veprës penale Sulmi në bashkëkryerje nga neni 187 par.2 lidhur me nenin 31 të KPK-së, I.K.edhe për veprën penale Mbajtja në pronësi, kontrollë, posedim të paautorizuar të armëve nga neni 374 par.1 të KPK-së.

Me aktvendimin PKR.nr.454/15 të dt: 05.02.2018 Gjykata ka veçuar procedurën penale ndaj të akuzuarit A.R., meqenëse i njehti në këtë periudhë kohore është gjindur jashtë Kosovës dhe ka qenë i pa arritshëm për gjykatën.

Gjykata ka caktuar seancën e shqyrtimit gjyqësorë me dt: 09.07.2018, dhe pas leximit të aktakuzës, i akuzuari A.R., pas konsultave të mjaftueshm me mbrojtësen e tij, delaron se e pranonë fajsinë për veprën penale e cila i vëhet në barrë, të cilin pranim të fajsisë e ka bërë në seancën e shqyrtimit gjyqësorë, e me të cilin pranim është pajtuar edhe prokurori i shtetit. Gjykata vlerësoj se janë përmbushur të gjitha kushtet nga neni 248 par.1 i KPPRK –së, pikërisht se i akuzuari e ka kuptuar natyrën dhe pasojat e pranimin të fajsisë. Pranimi i fajsisë është bërë në mënyrë vullnetare, se pranimi i fajsisë mbështetet në faktet e çështjes që përmbanë aktakuza, në materialin e prezantuar nga prokurori i shtetit, të pranuar nga i akuzuari. Prandaj gjykata e aprovoj pranimin e fajsisë nga ana e të akuzuarit, sepse janë përmbushur kushtet për pranimin e fajsisë nga neni 248 par 1 të KPPK –së.

Gjykata paraprakisht të akuzuarin e ka udhëzuar se me pranimin e fajësisë i njejtit do të shpallët fajtorë për veprën e cekur më lartë dhe do t'i shqiptohet sanksioni i paraparë me ligj, mirëpo gjykata gjatë marrjës së vendimit mbi denimin, do ta ketë parasysh pranimin e fajësisë si rrethanë lehtësuese.

Duke e marr parasysh se në shqyrtimin gjyqësorë ka ardhur deri te pranimi i fajësisë nga ana e të akuzuarit, gjykata pa prezentimin e provave ka kaluar në fjalën përfundimtare të palëve.

Prokurori i shtetit Armend Hamiti në fjalën përfundimtare ka deklaruar: se gjendja fatike e paraqitur në aktakuzë është vërtetuar në tërësi lidhur me të akuzuarin A.R., për shkak se në rastin konkret ekzistojnë elemente të veprës penale Sulmi nga par.2 të KPRK-së, dhe kjo u vërtetu përveq pranimit të fajësisë nga ana e të akuzuarit e poashtu edhe me deklaratat e dëshmitarëve: E.B., F.M., A.Z. dhe E.Sh. deklaratimet e të akuzuarëve të tjerë, me të cilat në tërësi u vërtetuar dyshimi mirë i bazuar se i akuzuari ka kryer veprën penale Sulm nga neni 187 par.2 të KPRK-së. Andaj gjykates i propozoi që përveç këtyre rrethanave rënduese që janë vërtetu me prova, në rastin konkret të merr parasysh si rrethanë lehtësuese moshën e tij të të re edhe pranimin e fajësisë, duke e shpall fajtor e gjykoj sipas ligjit me një denim me të cilin do të arrihet qëllimi i denimit që i njejtë të ri socializohet dhe të mos përsëritë vepra të ngjashme penale .

Mbrojtësja e të akuzuarit A.R.av.L.B.-Y. në fjalën përfundimtare ka deklaruar: Meqenëse i akuzuari A.R.e pranoj fajësinë në seancën e sotme për veprën penale që i vihet në barrë dhe shprehi keqardhje për rastin që ka ndodh, me premtimin para këtij trupi gjykues se në të ardhmen nuk do përsëris vepra të tilla apo të ngjashme penale. Prandaj nën këto rrethana si dhe duke marr parasysh faktin se në kohën e kryerjes së veprës penale i mbrojturi im thujse pak kohë pas mbushjes së moshës 18 vjeçare në kohën kur ka qenë madhor i ri, që gjykata të ket konsideratë këtë rrethanë, faktin se nga ajo kohë tashmë 4 vite asnjëher nuk ka ra ndesh me ligjin, e posaqërisht rrethanën se po në rastin konkret ka qenë më i dëmtuari vëllau i tij, ndoshta këto kanë qenë edhe arsyet për të ndërhy në rastin konkret. I propozojmë gjykatës që edhe me një vërejtje gjyqësore, duke pas parasysh rrethanat e lartëcekura, konsiderojmë se mjaftueshëm do të arrihet edhe qëllimi i denimit.

I akuzuari A.R.në fjalën përfundimtare deklaroi se: E përkrahi në tërësi fjalën përfundimtare të mbrojtëses dhe shprehi keqardhje për rastin që ka ndodhur, ëshëm penduar thellë për veprimet e tija dhe në të njejtën kohë i ka premtuar gjykatës se në të ardhmen nuk do bie në kundërshtim me ligjin duke thekësuar se kjo ka qenë hera e parë që kam ardh në kundërshtim me ligjin. Që 1 vit e tre muaj qendron në Gj., ëshët me leje qendrimi dhe me vizë të punës, duek premtuar se nuk do të kryer veprat tjera penale duke shtuar se me të akuzuarit e tjerë ëshëti pajtuar, në mes tyre ekzistojnë raporte të mira shoqërore. Në fund e ka lytë gjykatën këto ti merë parasysh me rastin e vendosjes në lidhje me denim dhe ndaj tij të merë një denim sa ma të butë .

Me rastin e përcaktimit të denimit Gjykata pati parasyshë të gjitha rrethanat lehtësuese dhe rënduese që ndikojnë në llojin dhe lartësinë e denimit, kështu që ndaj të akuzuarit morri parasyshë pranimin e fajësisë dhe pendimin e thellë të shprehur gjatë shqyrtimit gjyqësorë, si rrethanë veqanarisht lehtësuese, sjelljen korrekte të njejtit, ka të kryer

shkollën e mesme, , i pamartuar, i gjendjes së mesme ekonomike,. Ma parë jo i gjukuar dhe se ndaj tij nuk zhvillohet ndonji procedyre tjeter penale Nga rrethanat rënduese gjykata asgjë nuk gjeti. Andaj gjykata të akuzuarin e shpalli fajtorë dhe e gjykoi si në dispozitiv të këtij aktgjykimi,duke I aplikuar dispozitat ligjore për zbutje të denimit me bindje se denimi i shqiptuar i përgjigjet shkallës dhe përgjegjësisë penale dhe i njejt do të shërbejë si preventivë individuale dhe gjenerale dhe parandalim se në të ardhmën nuk do të kryen vepra penale, duke ndikuar në rehabilitimin e tij.

Gjykata është e bindur se me denimin e shqiptuar në tërësi do të arrihet qëllimi i denimit siç është rregulluar me nenit 41 të KPRK-së.

Vendimin mbi shpenzimet e procedurës penale gjykata e morri në bazë të nenit 450 par.2 nën.par.2.6 të KPPRK-së.

Nga se u cek me lartë u vendos si në dispozitiv të këtij atkgjykimi

GJYKATA THEMELORE NË PRISHTINË
DEPARTAMENTI PËR KRIME TË RËNDA
PKR.nr.33/18, të dt. 09.07.2018

Procesmbajtësi,
Arianit Mahmutaj

Kryetarja e trupit - gjyqtarja,
Shadije Gërguri

KESHILLË JURIDIKE: Kundër këtij aktgjykimi është e lejuar ankesa në afat prej 15 /pesëmbëdhjetë/ ditë nga dita e pranimit të këtij aktgjykimi, Gjykatës së Apelit në Prishtinë, e përmes kësaj Gjykate